



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

URDHËR

Nr. 104 Datë 24 . 03. 2004

PËR

**DISA PLOTËSIME NË URDHËRIN NR. 284 DATË 19. 12. 2002 "PËR MBAJTJEN,
PLOTËSIMIN DHE RAPORTIMIN E TË DHËNAVE STATISTIKORE NË
PROKURORI"**

Me synim,

- plotësimin, përpunimin, analizën, ruajtjen dhe raportimin e të dhënave statistikore në Prokurorite për Krime të Rënda, si dhe;
- pasqyrimin në të dhënat statistikore të Prokurorive të ndryshimeve dhe plotësimeve në legjislacionin penal;

Mbështetur, në nenet 8 pika 2, 4 e vijues të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorise në Republikën e Shqipërisë ", në ligjin Nr.7687 datë 16. 03. 1993 "Për Statistikën" etj;

U R D H Ë R O J

Ne urdhërin Nr. 284 datë 19. 12. 2002 "Për mbajtjen, plotësimin dhe raportimin e të dhënave statistikore në Prokurori", bëhen disa plotësime si më poshtë:

1. Pas pikës 1-1.1.1, shtohet pika 1.1.2, si më poshtë:

1.1.2 Prokuroria për Krime të Rënda" të mbajë të dhëna statistikore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore, si më poshte:

- a. Evidenca e Referimeve te Krimeve të Rënda, civile dhe Ushtarake, Model PrKR 1R dhe Model PrKRU 1R;
- b. Evidenca e Masave te Sigurimit, Model PrKR 1Ms dhe IModel PrKRU 1 Ms;
- c. Evidenca e Treguesve të Ndjekjes Penale sipas Veprave Penale, Model PrKR 1Vp dhe Model PrKRU 1Vp;
- d. Evidenca e Zgjatjeve të Afatit të Hetimeve Paraprake, Model PrKR 1Zgj dhe Model PrKRU 1Zgj;
- e. Evidenca e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Model PrKR 1Ek dhe Model PrKRU 1Ek;
- f. Evidenca e Treguesve të Marrëdhënieve Juridiksionale me Autoritetet e Huaja, Model PrKR 1Mj dhe Model PrKRU 1Mj, si dhe;
- g. Evidenca mujore me Treguesit sipas Vendimeve Gjyqësore,

ModelThKR 1Vgj."

2. Në pikën I - A, pas fjalës ushtarake, hiqet presja dhe shtohen fjalët "dhe i Prokurorisë për Krime të Rënda".

3. Pas pikës I - 1.2.1 shtohet pika 1.2.2, si më poshtë:

1.2.2 Prokuroria e Apelit për Krime të Rënda të mbajë të dhena statistikore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe yjetore, si më poshtë:

- a. Evidenca e Treguesve për Çështjet e Shqyrtuara në Themel, sipas Prokurorive, Model Th 2PrKR;
- b. Evidenca e Treguesve për Shqyrtimin e Masave të Sigurimit Personal, sipas Prokurorive, Model Ms 2PrKR;
- c. Evidenca e Treguesve për Çështjet e Shqyrtuara në Themel, sipas Veprave Penale, Model Th 2KR;
- d. Evidenca e Treguesve për Shqyrtimin e Masave të Sigurimit Personal, sipas Veprave Penale, Model Ms 2KR, si dhe;
- e. Evidenca mujore me Treguesit sipas Vendimeve Gjyqësore, Model Th 2VgjKR."

4. Në pikën II - 2.2, pas fjalës rrethit gjyqësor, shtohen fjalët "dhe në Prokurorinë për Krime të Rënda".

5. Në pikën II - 2.3, pas fjalës Apelit, shtohen fjalët "dhe në Prokurorinë e Apelit për Krime të Rënda".

6. Në pikën III - 3.1, pas fjalës Apelit, vendoset presje dhe shtohen fjalët "Prokuroritë për Krime të Rënda".

7. Me këtë urdhër të njihen operatorët, oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe drejtuesit e Prokurive të gjithë niveleve.

8. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë,

PROKURORI I PËRQJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU